

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Histori

(klasa e tetë)

Tiranë, 2006

1. TË PËRGJITHSHME

Programi “Njohuri për historinë botërore të shekullit XX” për klasën VIII të shkollës 9 vjeçare përfshin studimin e zhvillimeve më të rëndësishme të shoqërisë njerëzore gjatë shekullit që lamë pas, dhe synon një trajtim sa më objektiv të tyre. Programi do të zhvillohet me dy orë në javë, pra 70 orë vjetore sipas planit mësimor të dërguar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Prej tyre 60 orë do të jenë njohuri të reja dhe përsëritje, 10 orë të lira në dispozicion të mësuesit.

Programi është alternim i temave me karakter përgjithësues për problemet më të rëndësishme të zhvillimit botëror me temat historike të vendeve të veçanta, të cilat kanë dhënë një ndihmesë të rëndësishme në tërë zhvillimin historik të shoqërisë.

I parë në një këndvështrim të tillë, programi i ri në ndryshim nga paraardhësi përmban ndryshime të rëndësishme si në strukturë, ashtu edhe në përmbajtje. Disa karakteristika të këtij programi janë:

- Pasqyrimi i njohurive, shprehive dhe vlerave edukative, në formën e objektivave kryesore që duhet të përvetësojnë nxënësit në përfundim të studimit të lëndës, çka përbën një ndryshim të rëndësishëm strukturor dhe e ndihmon mësuesin për një vlerësim sa më objektiv të arritjeve.

- Vendosja e një raporti më të drejtë ndërmjet aspekteve të zhvillimeve politike, diplomatike, nga njëra anë, dhe ekonomike, kulturore e sociale, nga ana tjetër.

- Shtimi i numrit të orëve kushtuar studimit të vendeve fqinje të rajonit të Ballkanit, duke synuar në këtë mënyrë rritjen e mëtejshme të mirëkuptimit, stabilitetit dhe të respektit të ndërsjellë ndërmjet popujve tanë në shërbim të aspiratës së tyre të përbashkët, anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Objekti i studimit të lëndës “Njohuri për historinë botërore të shekullit XX” është zhvillimi i njeriut dhe i shoqërisë njerëzore të shekullit XX në përmasat civile, ekonomike, sociale, politike dhe fetare.

2. SYNIME TË LËNDËS

Në përfundim të studimit të kësaj klase nxënësit duhet të:

Kronologji

- Jenë të aftë të rendisin ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike, brenda kufijve kronologjikë të përfshirë në studim.
- Jenë të aftë të përdorin me përpikmëri terminologjinë e ngjarjeve dhe të dukurive historike të zhvillimeve të shekullit XX të përfshirë në studim, si: epokë e bukur, Lidhja e Kombeve, diktaturë, totalitarizëm, fashizëm, komunizëm etj.

Gjerësia dhe thellësia e njohurive historike

- Njohin e përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike të përfshira në studim, si: qytetërim perëndimor, demokraci, ndërvarësi botërore, shtet totalitar, liberalizëm etj.
- Zotërojnë fjalorin e duhur në përputhje me përmbajtjen e lëndës dhe e përdorin atë.
- Dinë të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të shoqërisë njerëzore në shekullin XX.
- Dinë të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike, të situatave dhe ndryshimeve të ndodhura në vendet e përfshira në studim.
- Jenë të aftë për të vlerësuar ndryshimet e rëndësishme që karakterizuan zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të shoqërisë njerëzore gjatë shekullit XX, si dhe rolin e figurave të ndryshme historike në këtë drejtim.

- Njohin disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës dhe teknologjisë të periudhës së përfshirë në studim.

Interpretimi historik

- Jenë të aftë të kuptojnë se për ngjarje, procese e figura të ndryshme historike ka interpretime të ndryshme.
- Jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar ndaj pikëpamjeve të ndryshme për zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore të shekullit XX, duke dalluar faktet nga opinionet.
- Dinë të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike.
 - Jenë të aftë për të debatuar dhe për të arritur në kompromise për probleme të caktuara.
 - Jenë në gjendje të interpretojnë tablo, foto, harta historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike të përfshira në studim.
 - Jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet, duke nxjerrë përfundime përkatëse për ngjarje, figurat, fakte apo dukuri historike të studiuara.

Kërkime historike

- Jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të periudhave historike të studiuara të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si dokumente historike, foto, tablo, harta historike etj.
- Jenë të aftë për të bërë pyetje në shërbim të grumbullimit të informacionit të duhur për çështje të ndryshme të përfshira në studim.
- Jenë të aftë për të zbuluar informacione të rëndësishme nga burime të ndryshme historike të dorës së parë dhe të dytë (harta, materiale të shkruara, ilustrime të ndryshme etj.) në shërbim të çështjeve të përfshira në studim.

Organizimi dhe komunikimi

- Dinë të përzgjedhin dhe të rendisin në mënyrë logjike të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme historike për vendet dhe periudhat e studiuara.
- Dinë të komunikojnë njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e periudhave historike të studiuara duke përdorur për këtë qëllim teknika të ndryshme, si: përshkrimi, shpjegimi etj.
- Marrin pjesë në debate ku nëpërmjet njohurive dhe aftësive të fituara, të japin ndihmesë në arritjen e kompromiseve për probleme të caktuara.

3. TEMATIKAT KRYESORE

- BOTA NË FILLIM TË SHEKULLIT XX . LUFTA E PARË BOTËRORE
- TRAKTATET E PAQES DHE PROBLEMET E PAZGJIDHURA TË PASLUFTËS
- DIKTATURAT. TOTALITARIZMI KOMUNIST E FASHIST
- DEMOKRACITË PERENDIMORE NË VITET 1918-1939
- VENDET E BALLKANIT DHE KONTINENTET E TJERA NË VITET 1918-1939
- LUFTA E DYTË BOTËRORE; NDARJA E BOTËS NË DY BLOQE
- KONSOLIDIMI I DEMOKRACISË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I EVROPËS PERENDIMORE DHE I SHBA -ve 1945-1990
- BLOKU KOMUNIST. DËSHTIMI I KOMUNIZMIT 1945-1990
- VENDET E BALLKANIT DHE BOTA JOEVROPIANE NË VITET 1945-1990
- SHKENCA, KULTURA, ARTI DHE PROBLEMET E BOTËS SË SOTME

4. OBJEKTIVAT DHE TEMATIKAT

Arritjet e përshkruara në synimet e lëndës realizohen nëpërmjet objektivave dhe tematikave të mëposhtme:

Tematika 1

BOTA NË FILLIM TË SHEKULLIT XX . LUFTA E PARË BOTËRORE

Objektivat :

Në përfundim të kësaj tematike nxënësit të jenë në gjendje:

- Të rendisin ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme ekonomike, sociale e politike që karakterizuan botën në fillim të shekullit XX, përfshirë Luftën I Botërore, brenda kufijve kronologjikë të përfshirë në studim.
- Të jenë të aftë të përdorin me përpikmëri terminologjinë e ngjarjeve dhe të dukurive historike të zhvillimeve në fillimet e shekullit XX etj.
- Të njohin e të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike në këtë periudhë të përfshira në studim, si: luftë botërore, lëvizje qytetare etj.
- Të zotërojnë fjalorin e duhur në përputhje me këtë përmbajtje dhe ta përdorin atë.
- Të dinë të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e fillimit të Luftës I Botërore dhe zhvillimeve më kryesore para dhe pas saj.
- Të jenë të aftë të kuptojnë se për ngjarje, procese e figura të ndryshme historike ka interpretime të ndryshme.
- Të jenë në gjendje të interpretojnë tablo, foto, harta historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike.
- Të jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarje, figura, fakte apo dukuri historike të studiuara.
- Të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të studiuara të periudhës së fillimit të shekullit XX, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo, harta historike etj.
- Të jenë të aftë për të bërë pyetje në shërbim të grumbullimit të informacionit të duhur për çështje të ndryshme.
- Të jenë të aftë për të zbuluar informacione të rëndësishme nga burime të ndryshme historike të dorës së parë dhe të dytë (harta, materiale të shkruara, ilustrime të ndryshme etj.)

Tematika:

- Fuqitë botërore në një baraspeshë të vështirë.
- Epoka e bukur: besimi te zhvillimi. Lëvizjet qytetare dhe punëtore.
- Fillimi i Luftës.
- Zhvillimi i Luftës. Fronti Perëndimor.
- Fronti Lindor dhe frontet e tjera. Përfundimi i luftës.

Tematika 2

TRAKTATET E PAQES DHE PROBLEMET E PAZGJIDHURA TË PASLUFTËS

Objektivat :

Në përfundim të kësaj tematike nxënësit të jenë në gjendje:

- Të rendisin zhvillimet më të rëndësishme ekonomike, sociale e politike që karakterizuan botën në periudhën 1918-1939 të përfshira në studim.
- Të jenë të aftë të përdorin me përpikmëri terminologjinë e zhvillimeve historike të kësaj periudhe të përfshirë në studim, si: Lidhja e Kombeve, konferencë paqeje, traktat paqeje etj.
- Të zotërojnë fjalorin e duhur të kësaj periudhe të përfshirë në studim dhe ta përdorin atë.
- Të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më kryesore që karakterizuan zhvillimet e shoqërisë njerëzore në vitet 1918-1939 .
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike të kësaj periudhe.
- Të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të periudhave historike të studiuara, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo, harta historike etj.
- Të jenë të aftë për të bërë pyetje dhe t'u përgjigjen atyre në shërbim të grumbullimit të informacionit të duhur, duke veçuar pjesën më të rëndësishme nga pjesa më pak e rëndësishme.

Tematika :

- Konferenca e Paqes e Parisit dhe krijimi i Lidhjes së Kombeve.
- Rrjedhjet e Luftës.
- Prirjet kryesore të zhvillimeve gjatë viteve 1918-1939.

Tematika 3

DIKTATURAT. TOTALITARIZMI KOMUNIST E FASHIST

Objektivat:

Në përfundim të kësaj tematike nxënësit të jenë në gjendje:

- Të jenë të aftë të rendisin saktë kronologjikisht ngjarjet dhe faktet më të rëndësishme në lidhje me zhvillimet e totalitarizmit komunist e fashist në këto vende në vitet 1918-1939 brenda kufijve kronologjikë.
- Të përdorin me përpikmëri terminologjinë e këtyre ngjarjeve dhe të dukurive historike, si: diktaturë, totalitarizëm, fashizëm, komunizëm etj.
- Të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike si: shtet totalitar, diktaturë etj.
- Të dinë të përshkruajnë dhe të analizojnë, tiparet më karakteristike të zhvillimit të regjimeve totalitare të vendosura në Rusi, Itali, Gjermani e Spanjë.
- Të dinë të shpjegojnë shkaqet e vendosjes së këtyre diktaturave dhe pasojat që sollën ato për këto vende dhe popujt e tyre.
- Të dinë të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet e shkaqet e vendosjes së këtyre regjimeve totalitare.

- Të jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarjet, figurat, faktet që lidhen me këto sisteme qeverisëse diktatoriale.

Tematika:

- Përmbysja e regjimit carist në Rusi. Vendosja e plotë e regjimit totalitar komunist.
- Tiparet e regjimeve totalitare.
- Italia gjatë viteve 1918-1939. Vendosja e fashizmit.
- Gjermania republikane dhe ardhja në pushtet e Hitlerit.
- Lufta civile në Spanjë.

Tematika 4

DEMOKRACITË PERENDIMORE NË VITET 1918-1939

Objektivat :

Në përfundim të kësaj tematike nxënësit të jenë në gjendje:

- Të jenë të aftë të përdorin me përpikmëri terminologjinë e ngjarjeve dhe të dukurive që karakterizuan zhvillimet e demokracive perëndimore në vitet 1918-1939.
- Të njohin e të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike si: qytetërim perëndimor, demokraci, liberalizëm etj.
- Të dinë të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të demokracive perëndimore në vitet 1918-1939.
- Të njohin disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës gjatë viteve 1920-1930.
- Të jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar për zhvillimin ekonomik, social e politik të vendeve demokratike gjatë viteve 1918-1939, duke dalluar faktet nga opinionet.
- Të dinë të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike për këto vende gjatë kësaj periudhe të përfshira në studim.
- Të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të kësaj periudhe historike të studiuar, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo etj.

Tematika:

- SHBA në vitet „20. Kursi i ri i Ruzveltit.
- Britania e Madhe në vitet 1918-1939.
- Franca në vitet 1918-1939.
- Kultura dhe arti në vitet 1920-1930.

Tematika 5

VENDET E BALLKANIT DHE KONTINENTET E TJERA NË VITET 1918-1939

Objektivat :

Në përfundim të kësaj tematike nxënësit të jenë në gjendje:

- Të jenë të aftë të rendisin kronologjikisht saktë ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike të vendeve të Ballkanit dhe të kontinenteve të tjera në vitet 1918-1939.
- Të dinë të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të vendeve të Ballkanit dhe të kontinenteve të tjera në vitet 1918-1939.
- Të jenë të aftë për të vlerësuar ndryshimet e rëndësishme që karakterizuan zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të këtyre vendeve gjatë viteve 1918-1939 .
- Të dinë të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje a dukuri të ndryshme historike të këtyre vendeve.
- Të jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarje, figura, fakte apo dukuri historike të studiuara.
- Të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të periudhave historike të studiuara, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni.
- Të jenë të aftë për të zbuluar informacione të rëndësishme nga burime të ndryshme historike.

Tematika:

- Jugosllavia, Bullgaria, Rumania, Greqia, Republika e Turqisë, Shqipëria.
- Vendet e Azisë dhe të Afrikës, vendet e Amerikës Latine.

Tematika 6

LUFTA E DYTË BOTËRORE; NDARJA E BOTËS NË DY BLOQE

Objektivat:

- Të jenë të aftë të rendisin ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike që çuan në shpërthimin e Luftës II Botërore dhe pasojat e saj.
- Të jenë të aftë të përdorin me përpikmëri terminologjinë e ngjarjeve dhe të dukurive historike që karakterizuan këtë periudhë historike, si: luftë e ftohtë, revolucion tekniko-shkencor, integrim evropian etj.
- Të njohin e të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike të përfshira në studim, si: luftë e ftohtë, revolucion tekniko-shkencor, integrim evropian etj.
- Të dinë të përshkruajnë, të analizojnë dhe të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e shpërthimit të Luftës II Botërore dhe të zhvillimeve pas saj, si, p.sh., fillimi i luftës së ftohtë, ndarja e botës në dy blloqe etj.
- Të njohin disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore e kulturore të arritura gjatë zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor në periudhën e përfshirë në studim.
- Të jenë të aftë të kuptojnë se për ngjarje, procese e figura të ndryshme historike, ka interpretime të ndryshme.
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo figura të kësaj periudhe historike të përfshira në studim..
- Të jenë në gjendje të interpretojnë tablo, foto, harta historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike.

Tematika:

- Shpërthimi i përshkallëzuar i luftës. Fitoret e para të Gjermanisë naziste.
- Sulmi kundër Bashkimit Sovjetik.
- Veprimet ushtarake në Ballkan.
- Disfata e Gjermanisë dhe Japonisë. Mbarimi i Luftës II Botërore.
- Përpjekjet për konsolidimin e paqes. Konferenca e Paqes e Parisit.
- ShBA dhe Bashkimi Sovjetik. Fillimi i luftës së ftohtë.
- Rindërtimi ekonomik. Revolucioni tekniko-shkencor.
- Hapat drejt integritit evropian.

Tematika 7**KONSOLIDIMI I DEMOKRACISË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I EVROPËS PERENDIMORE DHE I SHBA -ve 1945-1990****Objektivat:**

- Të rendisin kronologjikisht saktë ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet më të rëndësishme në lidhje me konsolidimin social dhe politik të demokracisë, si dhe zhvillimin ekonomik të Evropës Perëndimore dhe të SHBA -ve gjatë viteve 1945-1990 të përfshira në studim.
- Të përdorin saktë terminologjinë e ngjarjeve dhe të dukurive historike të zhvillimeve të këtyre vendeve të përfshira në studim.
- Të zotërojnë fjalorin e duhur dhe ta përdorin atë.
- Të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të shoqërisë në vendet e Evropës Perëndimore dhe SHBA-ve në vitet 1945-1990.
- Të vlerësojnë ndryshimet e rëndësishme që karakterizuan zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të këtyre vendeve, si dhe rolin e figurave të ndryshme historike në këtë drejtim.
- Të njohin disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës dhe teknologjisë
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarjet më të rëndësishme që i karakterizuan këto vende në vitet 1945-1990.
- Të jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarjet, figurat, faktet apo dukuritë historike të studiuara të këtyre vendeve
- Të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike etj., të cilat hedhin dritë për zhvillimet në këto vende.
- Të jenë të aftë për të bërë pyetje në shërbim të grumbullimit të informacionit të duhur për çështje të ndryshme të përfshira në studim.

Tematika:

- Britania e Madhe në vitet 1945-1974.
- Franca në vitet 1945-1974.
- Republika Federale Gjermane në vitet 1945-1974.
- Italia në vitet 1945-1974.
- Spanja në vitet 1945-1974.
- SHBA në vitet 1945-1974.
- Kriza e mesit të viteve 1970.
- Zhvillimet në vendet e tjera të Evropës Perëndimore.

- Hapat e tjerë në rrugën e integrimit evropian.

Tematika 8

BLLOKU KOMUNIST. DËSHIMI I KOMUNIZMIT 1945-1990

Objektivat:

- Të rendisin kronologjikisht saktë ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike të bllokut komunist brenda kufijve kronologjikë.
- Të zotërojnë fjalorin e duhur në përputhje me përmbajtjen e tematikës dhe ta përdorin saktë atë.
- Të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit ekonomik, social e politik të vendeve të Evropës Lindore gjatë viteve 1945-1990
- Të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike, të situatave dhe ndryshimeve në revolucionet e vitit 1989 në Evropën Lindore.
- Të jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar ndaj pikëpamjeve të ndryshme për zhvillimin historik të këtyre vendeve, duke dalluar faktet nga opinionet.
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarjet që çuan në përmbysjen e komunizmit në ish-BS dhe vendet e tjera të Evropës Lindore.
- Të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të periudhës historike të studiuar, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto etj.
- Të përzgjedhin dhe të rendisin në mënyrë logjike të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme historike për vendet e studiuara.

Tematika:

- Bashkimi Sovjetik gjatë viteve 1945-1990.
- Evropa Lindore nën sundimin komunist.
- Revolucionet e vitit 1989 në Evropën Lindore

Tematika 9

VENDET E BALLKANIT DHE BOTA JOEVROPIANE NË VITET 1945-1990

Objektiva:

- Të krijojnë linjën e kohës me ngjarjet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike të vendeve të Ballkanit dhe botës joevropiane në vitet 1945-1990.
- Të njohin e të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike që karakterizojnë këto vende.
- Të zotërojnë fjalorin e duhur në përputhje me përmbajtjen e kësaj tematike dhe ta përdorin atë.
- Të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të shoqërive ballkanike dhe atyre joevropiane në vitet 1945-1990.

- Të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike, të situatave dhe ndryshimeve të ndodhura në këto vende në vitet 1945-1990.
- Të jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar ndaj pikëpamjeve të ndryshme për zhvillimin historik të shoqërive të këtyre vendeve, duke dalluar faktet nga opinionet.
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike.
- Të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarjet, figurat, faktet apo dukuritë historike.
- Të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo, harta historike etj.

Tematika:

- Jugosllavia, Bullgaria, Rumania, Greqia, Turqia, Shqipëria.
- Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet vendeve ballkanike.
- Ndryshimet politike në Azi.
- Zhvillimet në vendet e tjera arabe të Lindjes së Mesme.
- Lufta për liri e pavarësi në vendet afrikane.
- Zhvillimet politiko-shoqërore në Amerikën Latine në vitet 1945-1990.

Tematika 10

SHKENCA, KULTURA, ARTI DHE PROBLEMET E BOTËS SË SOTME

Objektivat:

- Të rendisin ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet më të rëndësishme në fushat e artit, të shkencës, kulturës, si dhe problemet më të rëndësishme të botës së sotme.
- Të përdorin me përpikmëri terminologjinë e ngjarjeve dhe të zhvillimeve më të rëndësishme si: ndërvarësi ekonomike botërore, globalizim, ngrohje globale, efekti serrë etj.
- Të njohin e të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike të përfshira në studim, si: ndërvarësi ekonomike botërore, globalizim etj.
- Të zotërojnë fjalorin e duhur në përputhje me përmbajtjen e tematikës.
- Të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të artit, shkencës, kulturës, si dhe problemet më të rëndësishme të botës së sotme.
- Të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e problemeve të krijuara si rrjedhojë e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.
- Të njohin disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës dhe teknologjisë të kohës së sotme.
- Të jenë të aftë të kuptojnë se për procese e zhvillime të ndryshme në fushat e lartpërmendura, si dhe për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që karakterizojnë shoqërinë njerëzore, ka interpretime të ndryshme.
- Të jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar ndaj pikëpamjeve të ndryshme për këto zhvillime.
- Të marrin pjesë në debate ku nëpërmjet njohurive dhe aftësive të fituara të japin ndihmesë në arritjen e kompromiseve për probleme të artit, kulturës dhe shkencës.

Tematika

- Jeta e përditshme.
- Zhvillimet në shkencë dhe teknologji.

- Kultura dhe arti. Feja në botën e sotme.
- Ndërvarësia ekonomike botërore.
- Ballafaqimi i shoqërisë me sfidat për mbrojtjen e mjedisit dhe kundër ngrohjes globale.

5. SHPËRNDARJA E ORËVE

Në klasën VIII të arsimit të detyruar-9 vjeçar, historia do të zhvillohet në 35 javë mësimore me 2 orë në javë.

35 javë x 2 orë / javë = 70 orë.

KURRIKULA ZYRTARE	Sasia e orëve
Bota në fillim të shekullit XX . Lufta e Parë Botërore	5 orë
Traktatet e paqes dhe problemet e pazgjidhura të pasluftës	3 orë
Diktaturat. Totalitarizmi komunist e fashist	4 orë
Demokracitë perëndimore në vitet 1918-1939	4 orë
Vendet e Ballkanit dhe kontinentet e tjera në vitet 1918-1939	9 orë
Lufta e Dytë Botërore Ndarja e botës në dy blloqe	8 orë
Konsolidimi i demokracisë dhe zhvillimi ekonomik i Evropës Perëndimore dhe i ShBA –ve, 1945-1990	9 orë
Blloku komunist. Dështimi i komunizmit 1945-1990	3 orë
Vendet e Ballkanit dhe bota joevropiane në vitet 1945-1990	10 orë
Shkenca, kultura, arti. Problemet e botës së sotme	5 orë
KURRIKULA në dispozicion të mësuesit (Orët e lira)	10 orë

Zbatimi i kurrikulës së lirë

Qëllimi i orëve të lira (15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimit.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Qëllimi i orëve të lira është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve, shifrave e të dhënave të ndryshme historike, gjeografike, demografike, kulturore, industriale, bujqësore, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi të shoqëruara me vrojtime dhe të pasuara me detyra; në ferma në shërbim të një objektivi të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës edhe për një kapitull; lojëra të ndryshme zbatimëse me elementë që zhvillojnë të menduarin logjik dhe kritik; përforsimi i njohurive të shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësve ashtu edhe mësuesin, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndër-lëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndër-lëndore dhe u shërben arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duhet të bëhet duke analizuar me kujdes si programin edhe kërkesat që parashtrojnë veçoritë vendore.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

Realizimi i sugjerimeve të mësipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por dhe aftësinë e një krijuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë dhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart me vete ky rol.

6. INTEGRIMI

Historia duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e historisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

1. Së pari, historia mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë objektivat e saj.
2. Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e historisë për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

Shembuj

I. Edukimi qytetar dhe Historia

Lënda e historisë dhe ajo e edukimit qytetar kanë të përbashkët:

1. **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
2. **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj

Historia:

- u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret edukimi qytetar. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e edukimit qytetar për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe edukimit qytetar?

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuar në lëndën e edukimit qytetar në kurrikulën e historisë me kusht që përmasa e mësimi të historisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimi;
- Të lidhet me kurrikulën e edukimit qytetar;

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të historisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete që lidhen me jetën e përditshme të njeriut, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- **Përmasa vendore:** historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

II. Gjeografia dhe historia

1. *Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia dhe historia? Ato kanë të përbashkët:*

- **Konceptet:** mjedis, të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj.

2. *Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së historisë:*

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë;
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale;
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë;
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. *Në ç' mënyrë lënda e historisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë?*

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to;
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë;
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë;
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së gjeografisë dhe historisë?

1. Së pari, mësimet e gjeografisë kanë si pjesë përbërëse dhe objekt studimi mjedisin natyror. Ato duhet të lidhen me konceptet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, qytetarisë, si për shembull, me lidhjet e ndërsjella midis elementëve natyror dhe shoqëror të mjedisit dhe pasojat e tyre, si dhe të përfshijnë veprimtari të tilla si diskutimet etj.
2. Së dyti, përmasa e mësimi të historisë gjatë zhvillimit të temave të historisë duhet:
 - Të jetë çështja thelbësore e mësimi;
 - Të lidhet me kurrikulën e gjeografisë;

III. Shkenca dhe historia

Shoqëria e sotme, vazhdimisht shtron përpara nesh çështje që lidhen me jetën tonë si në plan vetjak ashtu edhe në plan shoqëror. Trajtimi dhe zgjidhja e këtyre çështjeve, shpesh herë, kërkon jo vetëm njohuri shkencore, por edhe aftësitë dhe shprehitë për t'u përfshirë në diskutime dhe veçanërisht për të bërë gjykimet kritike.

Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet shkencës dhe historisë?

- Çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull, çështja e ngrohjes globale;
- Ndikim i përparimeve teknike në shoqëri, për shembull, ndikim i internetit;
- Kontrolli i shkencës, për shembull, shpërndarja e fondeve për kërkime shkencore (do të përdorim miliarda lekë për të provuar që ka jetë në Mars, apo do t'i përdorim këto lekë për qëllime të tjera më të rëndësishme për shoqërinë e sotme?)

Lënda e historisë duhet të ndihmojë nxënësit:

- të reflektojnë dhe të diskutojnë për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore;
- të vlerësojnë rolin qendror të shkencës në botën e sotme;
- të kuptojnë karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.

Autorët e teksteve dhe mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së historisë, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje, jo vetëm do të ndihmonte në pasurimin e argumenteve dhe burimeve historike, por, duke ritheksuar lidhjen e mësimi të historisë me aspekte të ndryshme të realitetit, do të rriste edhe motivimin e tyre për këtë lëndë.

Mësuesit duhet të zgjedhin me kujdes pjesën nga kurrikula e shkencave të natyrës dhe të përcaktojnë jo vetëm objektivat e të nxënit por edhe mënyrën për t'i zbatuar ato qartësisht tek nxënësit.

7. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje më veçoritë e temave të ndryshme mësimore. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave të lëndës të parashikuar nga programi mësimor.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren **shpjegimi**, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin

në kohë e në hapësirë të dukurive e proceseve historike, **mësimi zbulues** nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre, **biseda**, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv, **diskutimi** që zgjidh problemin etj. Gjithnjë duhet mbajtur parasysh fakti se përdorimi i shpeshtë i metodave problemore e kërkimore mënjanojnë të mësuarin pasiv dhe mekanik të nxënësve.

Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme apo tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta etj.

8. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve të jetë sistematik dhe i larmishëm. Ai të përfshijë konceptet dhe njohuritë më të rëndësishme që duhet të përvetësojë nxënësi, duke shmangur hollësitë e panevojshme.

Vlerësimi sistematik, semestral apo vjetor, mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: me shkrim, me gojë (pjesërisht apo frontalisht), testimet etj. Në rastet kur zbatohen testet, të mbahen parasysh :

- Nxënësit duhet të jenë familjarizuar që më parë me këtë teknikë vlerësimi.
- Testi të përfshijë cilësitë më kryesore, ndërsa shkalla e vështirësisë të jetë në përshtatje me nivelin e përvetësimit të njohurive historike nga nxënësit.
- Të hartohet nga vetë mësuesi një sistem i thjeshtëzuar pikëzimi. Në këtë rast të mbahen parasysh disa nga cilësitë më kryesore të tij, si: vlefshmëria, besueshmëria, objektiviteti dhe përdorimi. Përveç regjistrit të klasës, njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit plotësohet më tej edhe nga shënimet vetjake të mësuesit.

Njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit plotësohet më tej edhe nga shënimet e vetë mësuesit. Mbajtja e shënimeve për gabimet tipike të nxënësve dhe mangësitë me karakter të ndryshëm që ata kanë për njohuri e shprehje të veçanta, do ta ndihmonte mësuesin në planifikimin më të mirë të veprimtarive didaktike të ardhshme.

Kujdes i veçantë të tregohet në qortimin dhe vlerësimin e detyrave të nxënësve, sidomos të punimeve që plotësohen hap pas hapi gjatë veprimtarive të pavarura. Në këto raste, mësuesi të shënojë me hollësi natyrën e gabimeve të mundshme, të shoqëruara këto me sqarimet përkatëse, por edhe të demonstrojë para klasës punimet më të mira duke i komentuar ato.